

**ARIANIT BUQINCA**  
**ZANA HOXHA**

**KONTRIBUTI I HULUMTUESVE TË HUAJ PËR QYTETIN ANTIK  
TË ULPIANËS**

**902.2(497.115)**

**ABSTRAKT:** Qyteti antik Ulpiana (*Justiniana secunda*) që mendohet të jetë themeluar nga fillimi i shekullit të I-rë nga perandori Trajan ose nga fillimi i shekullit të II-të nga perandori Hadrian, lokalizohet dhe hulumtohet për herë të parë gjatë viteve 1954-1959 nga arkeologu Emil Çershkov. Lokaliteti arkeologjik i Ulpianës është ndër qendrat më interesante arkeologjike në Kosovë dhe rajon, gjendet pranë minierave antike të Shashkocit dhe ka pozitë gjeostrategjike në udhëkryq të rrugëve Via Lissus- Naissus dhe Via Naissus-Ulpiana- Scupi-Thessaloniki. Në këtë punim do të shtjellohen rezultatet e hulumtimeve në fushën e historisë dhe arkeologjisë nga studiues vendor dhe të huaj. Fillimisht do të trajtohen informacionet e para për lokalizimin e rrënojave të qytetit, duke vijuar me rezultatet e para të hulumtimeve në terren, si dhe konkluzionet e hulumtuesve për datimin e shtresave kulturore të cilat do të reflektonin në ecurinë e hulumtimeve të mëtutjeshme. Interesimi ynë nxitet nga rezultatet e vëzhgimeve në terren si dhe hulumtimeve arkeologjike dhe gjeofizike pas vitit 1999 ku institucione me renome botërore nga Evropa kanë dhanë një kontribut të çmueshëm. Do të paraqiten rezultatet e këtyre projekteve dhe ndikimi që kanë pasur.

**Fjalët kyçe:** Ulpiana, hulumtime, Arkeologji, ekspert të huaj

**ABSTRACT: THE CONTRIBUTION OF FOREIGN RESEARCHERS FOR THE ANCIENT CITY OF ULPIANA**

The ancient city Ulpiana (*Justiniana Secunda*) is thought to be established by the beginning of the 1st century by the Emperor Trajan or the beginning of the 2nd century by the emperor Hadrian, explored for the first time during 1954-1959 by the archaeologist Emil Çershkov. Ulpiana archaeological site is among the most interesting archaeological centers in Kosovo and in the region, it is located near the ancient mining of Shashkoc and has a geostrategic position at the junction of Via Lissus- Naissus and Via Naissus-Ulpiana- Scupi-Thessaloniki. In this paper the results of the research in the field of history and archeology of domestic and foreign scholars will be discussed. First of all, the information of locating the ruins of the city will be elaborated, continuing with the results of the field research, as well as the conclusions of the researchers on dating of the cultural layers that would reflect the performance of further researches. Finally, our attention is prompted by the results of field surveys and archaeological and geophysical surveys after 1999 where world-renowned institutions from Europe have given valuable contribution. The results of their research will be presented as well as the impact of the research.

**Keywords:** Ulpiana, research, Archaeology, foreign experts

Lokaliteti antik romak dhe bizantin i Ulpianës është pa mëdyshje njëra nga qendrat më interesante arkeologjike në Kosovë dhe rajonin e gjerë të Gadishullit Ilirik. Shtrirja pranë depozitimeve minerare/xehetare të pasura me metale të çmueshme,<sup>1</sup> burimet e ujit të rrjedhshëm dhe mineral si dhe pozita kyçe gjeostrategjike në një udhëkryq rrugësh antike që lidhte lindjen me perëndimin, ishin faktorë përcaktues për themelimin, zhvillimin dhe ekzistencën e saj.

---

<sup>1</sup> Emil Çershkov, *Zanafillat e xehtarisë në Parahistori*, Përparimi 1-2, Prishtinë 1964, f. 75-82.

Jeta dhe gjurmët e para të civilizimit në Ulpianë janë dëshmuar që nga periudhat parahistorike, por duhet vënë theksin posaçërisht në periudhat e njohura si periudha e bronzit dhe ajo e hekurit, apo e njohur ndryshe si lashtësia dardane.<sup>1</sup>

Gjatë periudhës romake, Ulpiana ishte njëra nga qendrat kryesore komunikuese në mes të Konstantinopolit dhe Romës dhe pikërisht shumë pranë qytetit antik bëhej kryqëzimi i rrugëve që lidhte detin Adriatik me detin Egje dhe indirekt edhe me Detin e Zi. Për më tepër, është e njohur nyja komunikuese Via Lissus-Naissus dhe ajo e Scupit, rrjete këto komunikuese tokësore që takoheshin mu pranë Ulpianës.

Periudhën e hulumtimeve nga të huajt në Ulpianë mund ta ndajmë në tri faza:

Faza e parë - që identifikohet me periudhën e udhëpërshkruesve deri në vitin 1953.

Faza e dytë - Periudha e mbas luftës së dytë botërore respektivisht, nga viti 1953 deri në vitin 1995, dhe

Faza e tretë – Periudha e viteve 1999-2016 e tutje.

Përnjohja e terrenit në lokalitetin e Ulpianës fillon në vitet 1926 nga arkitekti Boskovic i cili vëren fragmente gjurmësh arkitektonike në afërsi të lokalitetit duke mos qenë i vetëdijshëm për rëndësinë e saj.<sup>2</sup> Ky lokalitet gjithashtu përmendet edhe në udhë përshkrimet e Sir Arthur Evans, por jo si tërësi në vetvete. Faza e dytë e gërmimeve në Ulpianë i përket kohës kur Kosova ishte Krahinë autonome në kuadër të Jugosllavisë.<sup>3</sup> Nga viti 1953 deri 1995 janë realizuar gërmime nga grupe arkeologësh të nacionalitetit serb por me ndërprerje. Hulumtimet arkeologjike në mënyrë sporadike në këtë lokalitet janë kryer në vitin 1953 nga I. Nikolic.<sup>4</sup> Në këtë periudhë Nikolic lokalizuan nekropolin verior jashtë fortifikimit verior të mureve rrethuese të Ulpianës.<sup>5</sup> Në vijim të punës së Nikolic, E. Čerškov vazhdon punën në këtë lokalitet për 6 vite me radhë.<sup>6</sup> Kështu duke zbuluar pjesët më monumentale të këtij lokaliteti. Zbulimi i sarkofagut nga shekulli i IV me material të importuar nga Prokonezis, dëshmon për rëndësinë e madhe dhe ekonominë stabile të këtij lokaliteti.<sup>7</sup> Gjithashtu, pranë Memories, ndërtesës ku ishte vendosur sarkofagu, janë gjetur edhe dy stela guri. Njëra prej së cilave ruan edhe sot mbishkrimin në gjuhën latine dhe gjendet në lokalitet.

Zbulim tjetër me rëndësi të veçantë në pjesën e brendshme të mureve rrethuese të Ulpianës, është ai i bazilikës paleokristiane me gjatësi 33.5 metra dhe gjerësi 14 metra.<sup>8</sup> Në vazhdimësi të punimeve u zbulua edhe terma romake dhe porta veriore e qytetit dhe një pjesë e mureve rrethuese që ishin masive me trashësi 3 m. Arkeologët e Muzeut të Kosovës me hulumtimet në vazhdim, erdhën në përfundimin që, lokaliteti ishte i përmasave të mëdha dhe me rëndësi të veçantë. Pjesë e fragmente të rrugës së qytetit *Cardo Maximus* si dhe “*Castrumi*” disa dhjetëra metra afër Ulpianës, u zbuluan në gjatë viteve 1957-1959.<sup>9</sup> Në përfundim të kësaj periudhe hulumtimesh intensive u gërmuan edhe një numër i konsiderueshëm mbetjet arkitektonike të ndërtesave publike si dhe nekropoli perëndimor i qytetit.<sup>10</sup>

<sup>1</sup> Databaza e Trashëgimisë Kulturore : [http://dtk.rks-gov.net/tkk\\_objekti.aspx?id=6688](http://dtk.rks-gov.net/tkk_objekti.aspx?id=6688)

<sup>2</sup> M. Berisha, *Ulpiana e Dardanisë në dritën e hulumtimeve arkeologjike*, Gërmime dhe studime arkeologjike në Kosovë 2000-2012, ASHAK, Prishtinë 2014, f. 289-328.

<sup>3</sup> E. Shukriu, *Fazat Zhvillimore të Arkeologjisë dhe Gërmimet e Pas Luftës*, 2014 f. 17-31

<sup>4</sup> L. Popović, E. Čerškov, *Ulpiana-Prethodni izveštaj o arheološkim istraživanjima od 1954 do 1956 god.* 1956, f. 319

<sup>5</sup> Po aty.

<sup>6</sup> Po aty.

<sup>7</sup> E. Dobruna-Salih, *Plastika Dekorative dhe Figurative e Gurit ne Dardani gjate Kohës Romake (Sepulkrake dhe e Kultit)*. Prishtine2003.

<sup>8</sup> Čerškov -Popovic, 1958, f. 319

<sup>9</sup> Nga hulumtimet e mëvonshme ekzistenca e një *Castrumi*, do të vihet në dyshim, duke e identifikuar me rindërtimin dhe riemërimin e qytetit të ndërtuar nga Justiniani e të përmendur nga Prokopi i Cezaresë, si Justiniana Secunda. [FelixTeichner, *On the ancient Twin-City of Ulpiana – Iustiniana Secunda (Kosovo): Capital of the Metalla Dardanica*, in: J. M. Álvarez – T. Nogales – I. Rodà (Hrsg.), *Actas del XVIII Congreso Internacional de Arqueologia Clásica* 2013, Merida, 2015, f. 271–275]

<sup>10</sup> E. Čerškov, *Ulpiana-kratak izveštaj o arheološkim istraživanjima u 1959 god.* GMKM-IV-V, Prishtinë 1956.

Arkeologët, Parovic dhe Pesikan nga Instituti Arkeologjik i Beogradit, pas një pauze të gjatë, në vitin 1981 rikthehen përsëri në lokalitet duke u përqendruar në pjesën afër portës veriore të qytetit. U zbuluan disa punishte artizanale dhe urna në varrezën parahistorike<sup>1</sup> Gërmimet vazhduan por në bashkëpunim me ekipin përgjegjës për konservimin e lokalitetit.<sup>2</sup> Faza e dytë e hulumtimeve përfundon me gërmimet shpëtuese të vitit 1995.<sup>3</sup>

Pas një të stagnimi të gjatë, në lokalitetin e Ulpianës në bashkëpunim me institucionet kërkimore shkencore ndërkombëtare, hulumtimet arkeologjike u ri-aktualizuan vetëm në vitin 2006. Dhe kjo, si rezultat i një memorandumit bashkëpunimi mes Universitetit të Prishtinës dhe Universitetit Pierre Mendès nga Franca i përfaqësuar nga profesorët Jean-Luc Lamboley dhe Edi Shukriu.<sup>4</sup> Objektiv i misionit të përbashkët ishte adresimi, nga fillimi, i problematikës së urbanizmit antik të lokalitetit, duke u bazuar në studimet e Maja Paroviç -Peshikan, të publikuara në revistën *Starinar* në vitin 1981.<sup>5</sup> Mungesa aktiviteteve hulumtuese për një periudhë të gjatë, nxitë ekipin franko-kosovar që të parashtrijë nevojën e përdorimit të teknikave të reja të hulumtimeve arkeologjike për rivlerësimin e kronologjisë relative të zhvillimit të jetës në qytet.

Rezultatet e hulumtimeve të ekipit franko-kosovar janë publikuar në revistën shkencore “Iliria e Jugut dhe Epiri në Antikitet” gjithashtu këto rezultate janë paraqitur në një simpoziumi të gjerë shkencorë të njohur me të njëjtin emër. Duke marrë parasysh kohën e shkurtër të punës, hulumtimet rezultuan me zbulime të konsiderueshme të dhënash, kryesisht të strukturave arkitektonike dhe të shtresave stratigrafike të cilat u datuan në faza të ndryshme, duke filluar nga periudha perandorake romake, deri në fillim të mesjetës. Ndër gjetjet më të rëndësishme të evidentuara të ekipit veçohet një thesar monedhash, i përbërë prej rreth 130 monedhave nga bronzi e që i përkasin epokës së Konstandinit. Përveç këtyre, gjatë hulumtimeve është nxjerr në dritë material i shumtë i fragmenteve nga enët, epruvetat, gotat dhe lotoret nga qelqi, dhe numër i konsiderueshëm i objekteve metalike si dhe mbetje osteologjike. Autorët e hulumtimeve përmendin nevojën e studimit të materialit të shumtë arkeologjik të zbuluar përgjatë 3 viteve, duke përfshirë qeramikën dhe monedhat të cilat duan një kohë më të gjatë trajtimi dhe përkushtimi.

Një memorandum tjetër i mirëkuptimit ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit të Kosovës dhe Institutit Arkeologjik të Bonit në vitin 2008, do të sjell në Ulpianë ekipet për hulumtime gjeofizike. Incizimet gjeofizike u realizuan në mbi 40 hektarë sipërfaqe me potencial urbanistik dhe arkitektonik në arealin e Ulpianës që përfshinë lokalitetet Shashkoc, Veletin, Janjevë, Mramor, Hanroc, Mareci, Voguçinc, Trubuhoc, etj.<sup>6</sup> Rezultatet e reflektuara do të pasqyrohen edhe në planifikimin e projekteve të mëtutjeshme arkeologjike nga Unvierziteti i Frankfurtit.<sup>7</sup> Si rezultat i të dhënave të arsyeshme në terren, nën udhëheqjen e Felix Teichner, në vitin 2009 realizohet ekspedita e parë bashkëpunuese gjermano-

<sup>1</sup> M. Parović-Pešikan., *Antička Ulpijana prema dosadašnjim istraživanjima*, *Starinar* n.s. XXXII, 1981-82, Beograd.

<sup>2</sup> G. Cvetković- Tomašević., *Ulpijana, Arheološka iskopavanja u središtu i južnom delu antičkog grada*, Saopštenja XV, Beograd 1983.

<sup>3</sup> G. Karović, H. Mehmetaj., *Ulpijana, arheološka istraživanja 1995. godine*, GDKS, Beograd 1996, f.66-70; Milot Berisha, ...po aty.

<sup>4</sup> A. Hajdari, P. Kabashi, J.-L. Lamboley, E. Shukriu, A. Skenderaj, *Premiers Résultats des campagnes de fouilles a Ulpiana (2006-2008)*, L'Illyrie méridionale et l'Épire dans l'Antiquité, Actes du Ve colloque international de Grenoble (8-11 octobre 2008) réunis par JEAN-LUC LAMBOLEY et MARIA PAOLA CASTIGLIONI, Völl. I-rë, f. 445-454.

<sup>5</sup> Po aty; M. Parovic, Pesikan, *Anticka Ulpijana prema dosadašnjim istraživanjima»* (Ulpiana antike në dritën e gjendjes aktuale të hulumtimeve), *Starinar* 32, 1981, f. 57-74.

<sup>6</sup> M. Berisha, A. Drafehn, Sh. Gashi, R. Gauß, M. Helfert, K. Luci, F. Lüth, P. Mertl, S. Reichler, G.Schafferer, F.Teichner, H. Wendling, *Archäologisch-geophysikalische Prospektion im Kosovo – Erste Resultate einer bilateralen Forschungskooperation*, *Archäologischer Anzeiger*, Halbband, AA 2012, 2, 2013, f. 65-92; Bericht der Römisch- Germanischen Kommission BAND 92, Frankfurt, 2011 f.530-536; Bericht der Römisch- Germanischen Kommission .. Frankfurt 2010, f.137-139.

<sup>7</sup> E. Shukriu, *Fazat ...*, po aty, f.24

kosovare.<sup>1</sup> Si rezultat janë identifikuar struktura arkitektonike ndër të cilat vlenë të theksohen muret rrethuese/fortifikuese përreth bazilikës, në këndet e së cilit gjendeshin 4 kulla vrojtimi. Gjatë viteve 2010-2012 është hulumtuar në masë të madhe pjesa veriorore dhe lindore e “castrum-it” si dhe disa kulla vrojtuese të murit fortifikues në pjesën jugore dhe perëndimore. Nga vrojtimet jointruzive, në mesin e strukturave tjera arkitektonike, vërehen për herë të parë strukturat e një bazilike të dytë dhe një pagëzimorjeje, pranë rrugës Graçanicë-Llapllasellë.<sup>2</sup>

Së këtejmi, në bazë të një marrëveshje bashkëpunimi në mes të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve të Republikës së Kosovës dhe Universitetit të Arteve të Bukura Mimar Sinan të Republikës së Turqisë, në vitin 2012 do të fillojnë gërmimet e para të Turqisë në ndonjë shtet të huaj.<sup>3</sup> Lokaliteti i parë i hulumtuar ishte rreth 100 metra në jug të portës veriore të qytetit në afërsi të tempullit romak. Më vonë, gërmimet ishin zgjeruar edhe në pjesën jugore e lokalitetit, ku objekt hulumtimi dhe studimi do të jenë bazilika dhe pagëzimorja e sipërpërmendur. Me rastin e hulumtimeve në veri-lindje të pagëzimitores u zbulua një bazilikë me dimensione 20 x 40m. Bazilika përbëhet nga dy anijata anësore, narteksti, nefi dhe përfundon me një absidë në lindje. Dyshemeja e bazilikës është e shtruar me mozaik gjeometrik. Gjithashtu, duhet përmendur se në të njëjtën kohë, gjatë vitit 2014 janë bërë hulumtime paralele nga Instituti Arkeologjik i Kosovës, me qëllim të parapërgatitjes së terrenit për themelimin e Parkut Arkeologjik të Ulpianës. Prezantimi i mozaikëve të bazilikës është bërë në simpoziumin *Actas del XIII Congreso AIEMA Madrid, 14-18 de septiembre de 2015 Luz Neira, Universidad Carlos III de Madrid (dirección y coordinación)*, me përjashtim të karakteristikës së mbivendosjes së mozaikëve në narteksin e bazilikës, ku njëri mozaik, më i vonë, është i vendosur mbi një më të vjetër duke e mbuluar tërësisht.<sup>4</sup> Gjithashtu, rezultatet e hulumtimit turk, janë botuar në revistën e Institutit Arkeologjik në Prishtinë, *Kosova Arkeologjike II* në vitin 2015. Që në hyrje të punimit Çetinkaya përshkruan një “historik” të shkurtër dhe relativisht subjektiv të dardanëve. Bazuar në burimet e “kulturave fqinje”, i paraqet ata si të nënshtruarit e Filipit të II-të të Maqedonisë dhe më vonë të Romakëve.<sup>5</sup> Është më se e evidente që ky përshkrim ka dallime me përshkrimin e Diodorit për dardanët.<sup>6</sup> Në historinë politike të dardanëve, Papazoglu i përshkruan si popullin më të vjetër, të cilët jetonin në Evropën Juglindore edhe para migrimeve thrako-frigase.<sup>7</sup> Periudhën e bronzit të vonë dhe asaj të hekurit në Ulpianë, Çetinkaya e demanton, duke ju referuar gabimisht prezencës së këtyre periudhave në arealin e Ulpianës, të artikuluar shkurtimisht në një guidë të shkurtër arkeologjike të autorit Milot Berisha.<sup>8</sup> Në guidën dhjetë-faqeshe bëhet fjalë për minierat afër Kështjellës dardane të Veletinit. Këtu, janë dëshmuar vazhdimësitë shumë-shtresore që nga parahistoria, periudha e bronzit, e hekurit, periudhën e Mbretërisë Dardane, romake e bizantine e deri në mesjetë.

<sup>1</sup> F. Teichner, *Ulpiana/Iustiniana Secunda...*, pun. i cit. 2015, f. 271–275; Felix Teichner, *Ulpiana - Iustiniana secunda (Kosovo): Das urbane Zentrum des dardanischen Bergbaubezirks*, *Ephemeris Napocensis* 25, 2015, f. 81–93.

<sup>2</sup> F. Teichner; Umzeichnung: R. Urbanková, *Brno Bericht...*, 2011, po aty, f.530.

<sup>3</sup> H. Çetinkaya, *Kosova Arkeologjike*, Prishtinë 2015, f.99; H. Çetinkaya, *Stusia Academica Šumenensia* 3, Shumen University Press, 2016, f. 30-46.

<sup>4</sup> H.Çetinkaya, *Newly discovered Early Christian Mosaics from Ulpiana / Kosovo*, *Actas del XIII Congreso AIEMA Madrid, 14-18 de septiembre de 2015. Luz Neira, Universidad Carlos III de Madrid (dirección y coordinación)*, Romë 2016. f. 372-381.

<sup>5</sup> H. Çetinkaya, .. *po aty*, f.99.

<sup>6</sup> Diodore, V, 48, 2-4. (... και πρώτον εἰς τὴν Ἀσίαν (Turqinë e sotme) ἐπὶ σχεδίας διαπεραιωθέντα, τὸ μὲν πρώτον κτίσαι Δάρδανον πόλιν και τὸ βασιλείον τὸ περὶ τὴν ὕστερον κληθεῖσαν Τροίαν συστήσασθαι και τοὺς λαοὺς ἀφ’ ἑαυτοῦ Δαρδάνους ὀνομάσαι. ἐπάρξαι δ’ αὐτὸν φασι και πολλῶν ἔθνων κατὰ τὴν Ἀσίαν, και τοὺς ὑπὲρ Θράκης Δαρδάνους κατοικίσαι...).

<sup>7</sup> F. Papazoglu, *The Central Balkan tribes in pre-roman times (Triballi, Autariatae, Dardanians, Scordisci and Moesians)*, Amsterdam 1978, f. 131.

<sup>8</sup> (...within the area of Ulpiana all together are indicative that the roman Municipium of Ulpianum was erected on the previous ancient Dardanian settlement from the Bronze and Iron age), M. Berisha, *Kosova short archeological guide*, Prishtinë.

Në vazhdimësi të hulumtimeve me ekipin gjerman, në vitin 2015 në Ulpianë vazhduan përnjohjet gjeofizike nga Universiteti i Heidelbergut në bashkëpunim me Institutin Arkeologjik në Prishtinë. Hulumtimet përnjohëse kishin për qëllim identifikimin e mbetjeve apo themeleve të urbanizmit në pjesën e brendshme të qytetit përmes metodave jointrusive.

Aktualisht bashkëpunimet me karakter hulumtimi me ekipin francez vazhdojnë të realizohen. Në gusht të vitit 2016 Qendra Kombëtare e Hulumtimeve në Francë (CNRS) ka dërguar në Prishtinë një grup hulumtuesish, për studimin dhe publikimin e materialit arkeologjik të hulumtuar nga ekipet franko-kosovare në të kaluarën. Nën udhëheqjen e Christophe Goddard, Milot Berisha dhe Arben Hajdari,<sup>1</sup> ky ekip, pritet që së shpejti të publikojnë rezultatet preliminare të hulumtimeve, duke pasuar kështu me riaktivizimin e misionit bashkëpunues në Ulpianë, në vitet vijuese.

Duke u bazuar në materialin e përqendruar arkeologjik, studiuesit gjerman dhe francez, *Castrum*-in (fortesë legjionarësh romak) pranë Ulpianës e konsiderojnë të jetë një vendbanim, respektivisht Justiniana Sekunda. Por, kjo hipotezë e re dhe realisht e bazuar sa i përket rolit të saj si vendbanim, bie ndesh me informacionet që na ofron Prokopi rreth lokacionit.<sup>2</sup>

“... (Justiniani) i bëri shumë përmirësime qytetit (Ulpianës), duke e ndryshuar atë rrënjësisht; dhe e quajti Justiniana Secunda. Pranë saj ai ndërtoi një qytet të ri, të cilin e quajti Justinopolis sipas xhaxhait të tij...”

Në përshkrimin modest të Prokopit, kuptojmë që ai e njihte mjaftë mirë procesin e rindërtimit në këtë qytet të vjetër. Andaj, ri-aktualizimi i çështjes së statusit të *Castrumit* fqinj, bazuar në gjetjet e përqendruara arkeologjike, na shtynë që ta ri komentojmë përshkrimin e Prokopit. Nga ky përshkrim i Prokopit kuptojmë që pranë Ulpianës Justiniani ndërtoi një qytet tjetër të cilin e quajti Justinopolis. Në përkthimin e *De Aedificiis* të Prokopit nga Skender Anamali dhe Selim Islami në Ilirët dhe Iliria, fjalën “pranë” e gjejmë me sinonimin “fqinj”.<sup>3</sup> Në fakt përkthimi i Prokopit në latinisht “...*nec procul hinc*...” mund të artikulohet edhe në formën e “*jo larg nga këtu*”.<sup>4</sup> Kjo na nxitë të mendojmë, që në fakt “*Castrumi*” i fortifikuar dhe i identifikuar në fazën e dytë si i tillë, që gjendet disa dhjetëra metra në lindje të Ulpianës, i identifikuar në fazën e tretë si *Justiniana Secunda*, ndoshta, mund të jetë *Justinopoli*, i ndërtuar shumë më afër se ç’është kërkuar deri më tani, në arealin e Ulpianës. Megjithatë kjo mbetet vetëm një hipotezë.

---

<sup>1</sup> Në bashkëpunim me Universitetin e Prishtinës dhe Institutin Arkeologjik të Kosovës.

<sup>2</sup> Prokopi i Cezaresë, *De Aedificiis*, IV,1,17.

<sup>3</sup> Skender Anamali, Selim Islami, *Ilirë dhe Iliria te autorët antik*, 1965, f.439, (*Ai themeloi një qytet tjetër fqinj që e quajti Justinopol*)

<sup>4</sup> Jo larg nga Ulpiana.